



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 262/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.07.2020 shqyrtoi ankesat me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave standarte të tenderit për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-58406-05-18-2020, Loti 3, me objekt “*F.V. Pajisje radiologjike*”, me fond limit 25.666.667 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.06.2020, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ankimues: “Fedos” sh.p.k.
Njësia Administrative nr. 2, Rruga “Manol Konomi”,
Ndërtesa Nr. 14, Hyrja 2, Ap. 2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Rruga e Kavajës, nr. 1001, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.05.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-58406-05-18-2020, Loti 3, me objekt “*F.V. Pajisje radiologjike*”, me fond limit 25.666.667 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 26.05.2020, operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

[...]

Së pari, në dokumentat e tenderit ne 2. Kriteret e vecanta të kualifikimit pika 2.3. Kapaciteti teknik pika 11, kërkohet:

- 1. Ofertuesi duhet te kete ne stafin e tij jo me pak se 2 (dy) inxhinierë inxhinierë biomedikale ose elektronik ose informatik te trajnuar per servis pajisjesh mjekesore.*

Per kete duhet te paraqese:

- Diplomat perkatese
- Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për periudhën Janar 2020 - Prill 2020 ku të figurojnë emrat e tyre
- Certifikata/ose deshmi trajnimi te tyre per pajisjet me poshte **PER LOT 3:**

Pajisje radiologjike

Lidhur me këtë specifikim teknik të kërkuar nga ana juaj theksojmë se:

Kërkesa juaj për trajnime specifike në aparaturat e sipërcituara është një kriter që nuk stimulon pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse të operatorëve ekonomikë. Autoriteti kontraktor duke përcaktuar specifikime teknike të cilat i ofron vetëm një operator ekonomik e bën konkurimin jo të drejtë duke mos patur një konkurim të paanshëm ku të gjithë ofertuesit të ofertojnë produktet e tyre.

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006[...] neni 23 pika 3 gërma b) përcakton se: [...]

Specifikimi teknik i vendosur nga ana juaj është vetëm një e dhënë me qëllim eliminimin e konkurrencës në këtë procedurë prokurimi.

Në këtë rast kemi specifikime të cilat vetëm kufizojnë ofertat për këtë produkt pasi nuk justifikohet vendosja e specifikimeve teknike për trajnime për aparatura specifike.

Operatorët ekonomikë pa dyshim që në stafin e tyre duhet të kenë punonjës të trajnuar për instalimin përdorimin e pajisjeve mjekësore, por absolutisht nuk mund të detyrohet një operator ekonomik të ketë një staf të trajnuar vetëm për aparaturat që kërkohen nëpërmjet këtij prokurimi.

Operatorët ekonomikë mund të kenë në staf punonjës të trajnuar dhe që dinë mirë instalimin dhe përdorimin dhe trajnimin e stafit për pajisjet mjekësore me procese më të vështira në instalim dhe përdorim se pajisjet që prokurohen, ndaj vendosja e këtij kriteri ku ata duhet të jenë të trajnuar vetëm për pajisjet e ofertuara është në kundërshtim me LPP dhe aktet nënligjor në fuqi.

VKM nr. 914/2014 në nenin 30 përcakton që [...].

Në rastin konkret ky parim absolutisht nuk respektohet sepse, një operator ekonomik mund të ketë pjesë të stafit teknik inxhinierët biomedikal, të trajnuar për instalimin e pajisjeve mjekësore të punësuar me kohë të plotë ose me kontrata pune të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës por edhe kohëzgjatjes së kontratës duke plotësuar kështu më së miri kriterin e stafit teknik punëmarrës të trajnuar për aparatura mjekësore.

Kërkojmë që specifikimi:

- Certifikata/ose deshmi trajnimi te tyre per pajisjet me poshte **PER LOT 3:**

Pajisje radiologjike

Të modifikohet e të bëhet: Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjës të trajnuar për pajisjet mjekësore të vërtetuar me certifikata e trajnime.

Së dyti, në DST është përcaktuar tek shtojca 10 specifikimet teknike lot 3, për artikullin nr. 1, Mamografia Dixhitale kërkon ndër të tjera specifikime teknike si:

Kompensim automatic të tensionit

Kolimator automatik

Anoda të jetë prej Tungstenit ose më mirë për të zvogëluar dozën me përqëndrime afërsisht 0.1 – 0.3 mm dhe filtrim me material AL

Lëvizje vertikale min 45-125 cm

Rrotullimi Gantry për afërsisht : 0° , / $+90^{\circ}$; 0° /- 150° i motorizuar

Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (teshmange pixel binning).

1. Lidhur me specifikimin “Kompensim automatic të tensionit” theksojmë se:

- Kompensimi automatic i tensionit nuk duhet të jetë kërkesë për të qenë pjesë përbërëse e këtij sistemi. Sqarojmë që sistemi i kompensimit të tensionit, është një system elektrik (i përbërë nga kodensator të lidhur në parallel ose seri për përmirësimin e cos Ø dhe fuqisë reaktiv) i cili instalohet vetëm në sistemin elektrik. Kjo kërkesë nuk ka të bëjë me pajisjen e cila instalohet vetëm në sistemin elektrik. Kjo kërkesë nuk ka të bëjë me pajisjen e cila instalohet pas këtij sistemi. Pajisja mund të jetë jo vetëm radiologjike, por çdo lloj pajisje që ka momente të mëdha lëshimi dhe thithin shumë rrymë në një kohë shumë të shkurtër. Sisteme të tilla nuk janë pajisje mjekësore dhe duhet merren parasysh që në projektimin e rrjetit elektrik të godinës. Ju vëmë në dukje se kjo pajisje përdoret si artikull i veçantë dhe nuk i përket pajisjes së mamografisë dhe vendosja si specifikim i mamografisë mbyll në mënyrë të sigurt garën duke paracaktuar në mënyrë fituesin e kësaj procedure. Kjo është një system shtesë e cila nuk është pjesë e bashkëlidhur aparatit të mamografisë ndërkohë që në specifikime vendoset si pjesë e mamografisë. Nëse kërkohet ky sistem duhet të kërkohet si artikull më vete dhe jo me specifikimet e artikullit. Kërkojmë që ky specifikim të hiqet për të krijuar mundësinë e ofertimit të pajisjes kryesore të kësaj procedure prokurimi që është mamografia.

2. Lidhur me specifikimin “Kolimator automatik i pajisur me llampë LED” theksojmë se:

- Prodhues të ndryshëm për përfitimin e imazhit përdorin teknologji të ndryshme në ndërtimin e sistemeve të radiologjisë dhe kolimatorëve.
- E rëndësishme është arritja e qëllimit të pajisjes dhe jo mënyrë që përdorin prodhuesit për arritjen e qëllimit kryesor, ndaj përcaktimi i Pajisur me llampë LED është një përcaktim që nuk ka rëndësi për funksionin e kolimatorit, pasi dhe nëse përdoren llampa halogjene arrihet funksioni që kolimatori automatic ka.
- Kërkojmë që specifikimi “Kolimator automatic i pajisur me llampë LED” të modifikohet dhe të bëhet “Kolimator automatic i pajisur me llampë LED ose ekuivalent”
- Në përcaktimin /apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë dispozitat e sipërpërmendura urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë 11 i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

3. *Lidhur me specifikimet “Anoda të jetë prej Tungstenit ose më mirë për të zvogëluar dozën me përqëndrime afërsisht 01.-0.3 mm dhe filtrim me material Al, theksojmë se:*
 - AK absolutisht nuk ka arsye pse të specifikojë që materiali i filtrimit duhet të jetë AL, sepse operatorët ekonomikë mund të ofrojnë këtë funksion nëpërmjet teknikave të avancuara dhe që përdoren gjerësisht dhe realizojnë funksionin. Prodhues të ndryshëm përdorin teknika të ndryshme për filtrim që njihen dhe janë të aprovuara nga IAEA (Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike) e cila është një organizatë ndërkombëtare që kërkon të promovojë përdorimin paqësor të energjisë bërthamore dhe të frenojë përdorimin e saj për çdo qëllim ushtarak, përfshirë armët bërthamore.
 - Kërkojmë nga ana e AK që specifikimi “Anoda të jetë prej tungstenit ose më mirë për të zvogëluar dozën me përqëndrime afërsisht 01.-03 mm dhe filtrim me material Al”, të modifikohet dhe të bëhet: “Anoda të jetë prej Tungstenit ose më mirë për të zvogëluar dozën me përqëndrime afërsisht 01-0.3 mm dhe filtrim me material Al ose ekuivalent”
 - Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin public.
 - Këtë qëndrim në lidhje me përdorimin e termit “ekuivalent” mban edhe vetë Agjencia e Prokurimit Publik në REkomandimin nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim të dokumentave të tenderit të procedurave të prokurimit public”.
4. *Lidhur me specifikimin “Lëvizje vertikale min 45-125 cm” theksojmë se”*
 - Diapazoni i kërkuar për lëvizjen vertikale është specifike përjashtuese dhe favorizon prodhues të caktuar dhe AK në hartimin e specifikimeve teknike autoriteti kontraktor duhet të shmangë çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti /malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.
 - Kufiri i poshtëm i lëvizjes është një specifikim jo i saktë pasi nuk është e mundur të bëhet ekzaminimi i gjirit në kufirin e poshtëm 45 cm sepse është një kufi minimal shumë i vogël në krahasim me atë që realisht duhet.
 - Kërkojmë që specifikimi “Lëvizje vertikale min 45-125 cm” të modifikohet dhe të bëhet “Lëvizje vertikale afërsisht 60-130 cm”.
5. *Lidhur me specifikimin “Rrotullimiti Gantry për afërsisht: 0 ° / + 90 °; 0 ° / -150 ° i motorizuar” theksojmë që:*
 - Sipas këtij specifikimi nuk sqarohen këndet e rrotullimit, pozicioni referencë me të cilin llogariten këndet e kërkuara
 - AK duhet të sqarojë këtë specifikim duke i dhënë mundësinë gjithë operatorëve të kuptojnë çfarë konkretisht AK kërkon
6. *Lidhur me specifikimin Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (teshmange pixel binning) theksojmë se:*
 - Ajo që është thelbësore në këtë sistem është përfitimi i imazhit sa më i qartë dhe jo mënyra se si prodhues të ndryshëm realizojnë përfitimin. Termi “teshmange pixel binning” nuk përcakton llojin e kombinimit (binnig). Termi “pixel binning” do të thotë një process i cili

merr të dhëna nga 2 ose 4 pixela të kombinuar në një. Pra vetë përkthimi në shqip “duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit” me terminologjinë e kërkuar në anglisht “teshmange pixel binning” është teknologji kontradiktore. Në kërkesën në shqip kërkohet madhësia origjinale e vetëm një pikseli ndërsa në atë në Anglisht kërkohen kombinimi i disa pikselave në një.

Kërkojmë që specifikimi Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (teshmange pixel binning) të modifikohet dhe të bëhet: Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (teshmange pixel binnig) ose ekuivalente”

- Nga sa u theksua më lart vihet re që në këtë procedurë prokurimi Autoriteti kontraktor ka vendosur specifikime teknike të cilat të drejtojnë drejt një operatori ekonomik të caktuar i cili është distributor i kompanive të artikujeve të sipërcituar. Duke vendosur specifikime të tilla automatikisht autoriteti kontraktor tregohet diskriminues duke favorizuar vetëm një operator ekonomik dhe duke mos lënë mundësinë e ofrimit të produktit nga operatorë të tjerë.
- Përcaktimi i specifikimeve teknike të sipërpërmendura bën që të kemi një procedurë prokurimi jo të barabartë duke vendosur specifikime teknike të cilat nuk krijojnë kushte për konkurim të pashëm duke cënuar mundësinë e operatorëve ekonomikë që të paraqesin oferta ekonomike me cilësi dhe duke përmbushur kriteret dhe elementët kryesorë të DST. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin public.

Ligji nr. 9643/2006 neni 23 pika 3, gërma b përcakton që: [...]

Specifikimet e vendosura nga ana juaj janë vetëm të dhëna me qëllim eliminimin e konkurrencës në këtë procedurë prokurimi.

VKM 914/2014 në nenin 27 pika 1 përcakton që: [...]

Ligji nr. 9643/2006 neni 23 pika 1 përcakton që [...]

Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit bazuar në legjisilacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimale të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur për prokurimin publik. Këtë qëndrim në lidhje me përdorimin e termit ekuivalent mban edhe vetë Agjencia e Prokurimit Publik me rekomandimin 3334/1 prot., datë 20.03.2018 [....]. drejtuar autoriteteve kontraktore dhe në këtë kuadër si dhe në zbatim të frymës së legjisilacionit që rregullon fushën e prokurimit publik jemi para parimit Argumentum ab auctoritate fortissimum est in lege – pra para parimit se një argument i shkruar nga autoriteti më i lartë që është APP, ka fuqinë e ligjit për të gjithë aktorët si në cilësinë e AK ashtu dhe në cilësinë e OE. Dhe në rekomandimin e APP është e shprehur qartësisht që autoritetet kontraktore nuk duhet të vendosin specifikime teknike që të çojnë drejt një prodhuesi të caktuar.

Gjithashtu LPP në nenin 23/5 të saj ka përcaktuar që [...]

Autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma b dhe c e LPP janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm specifikimet teknike në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë /përjashtojnë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe / ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara parashikuar edhe nga neni 27 pika 1 e VKM 914/2014. Gjithashtu duke u ndalur në pikën 3 të nenit 23 të LPP ligjvënësi ka parashikuar tre metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me referimin e standarteve kombëtare, që mbështetet në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standarteve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë ato u referohen standarteve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve.

Metoda e dytë e hartimit të specifikimeve teknike lidhet me referimin e kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standarteve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale.

Ju bëjmë me dije se qëllimi që parashikon ligjvënësi për hartimin e kriterëve të përgjithshme apo të veçanta të kualifikimit nga ana e autoriteteve kontraktore nuk është të krijojnë ngërce apo hapësira apo pengesa për operatorët ekonomikë. Në fakt ai është diametrisht i kundërt: Qëllimi i hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit është që autoriteti kontraktor të krijojë bindjen se një operator ekonomik i disponon kapacitetet ligjore, financiare apo teknike për realizimin e procedurës së prokurimit. Për sa më sipër kërkojmë modifikimin e DST në lidhje me kriteret e mësipërme pasi përcaktimi i tyre në DST është në kundërshtim me LPP.

Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon se: [...]

Ligji 9643/2006 neni 46 pika 3 përcakton se: [...]

Autoriteti kontraktor harton dokumentat e tenderit në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Por sic shihet këto specifikime teknike janë diskriminuese që nuk krijojnë kushte të barabarta për pjesëmarrje dhe janë kërkesa të panevojshme për të dhe nuk janë në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

Kërkojmë që AK të marrë për bazë kërkesat tona për këtë procedurë për modifikimin e dokumentave të tenderit për të lejuar konkurimin e hapur dhe transparent për të gjithë operatorëve.

II.3. Në datën 28.05.2020, me shkresën nr. 2073/53 prot, operatori ekonomik ankimues është vënë në dijeni në lidhje me kthimin e përgjigjes nga autoriteti kontraktor dhe pranimin pjesërisht të ankesës së paraqitur prej tij pranë këtij të fundit.

Konkretisht AK ka pranuar ankesën në lidhje me materialin Al, është bërë një sqarim në lidhje me pretendimin për specifikimin teknik 45-125 cm.

II.4. Në datën 05.06.2020, operatori ekonomik ankimues ka depozituar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e kriterëve të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

Në lidhje me kthimin e përgjigjes të kthyer nga autoriteti kontraktor ankimuesi, pas pranimi të disa prej pretendimeve të tij ngre pretendime në lidhje me: kriterin për certifikatat /ose dëshmi trajnimi të tyre për pajisjet radiologjike duke kërkuar të modifikohet në: Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjës të trajnuar për pajisjet mjekësore të vërtetuar me certifikata e trajnime;

Për pajisjen mamografi dixhitale specifikimi “Kompensim automatik të tensionit”, kërkojmë që ju të riverifikoni atë që ne pretendojmë dhe kthim përgjigja e AK nuk mund të jetë e argumentuar nga specialist të fushës pasi do ishte e pamundur që specialist të fushës të përfshijnë në pajisjen bazë dhe një specifikim i cili duhet të jetë më vete.

Kërkojmë që ky specifikim të hiqet për të krijuar mundësinë e ofertimit të pajisjes kryesore të kësaj procedure prokurimi që është mamografia.

Për specifikimin “Kolimator automatic i pajisur me llampë Led” kërkojmë të shtohet fjala ekuivalent

Për specifikimin Rrotullimiti Gantry për afërsisht : 0° , / $+90^{\circ}$; $0^{\circ}/-150^{\circ}$ i motorizuar

Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (teshmange pixel binning) theksojmë që sipas këtij specifikimi nuk sqarohen këndet e rrotullimit pozicioni reference me të cilin llogariten këndet e kërkuara.

AK duhet të sqarojë këtë specifikim duke i dhënë mundësinë gjithë operatorëve të kuptojnë çfarë konkretisht AK kërkon.

Përgjigja e AK është një përgjigje standart e cila nuk bazohet në atë që ne kemi kërkuar pasi FEDOS nuk ka kërkuar që specifikimi të ndryshohet por ka kërkuar që AK të specifikojë këndet e rrotullimit pozicionin referencë me të cilin do llogariten këndet e kërkuara.

Në specifikimet teknike AK duhet të jetë më e qartë në atë që kërkon që të sigurojë qartësimin e të gjithë operatorëve ekonomikë dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në prokurim.

Në lidhje me specifikimin Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (teshmange pixel binning) theksojmë se të modifikohet dhe të shtohet “ose ekuivalente”.

Nga sa më lart vihet re që AK ka pranuar pjesën më të madhe të pretendimeve tona me të drejtë, pasi janë specifikime teknike të cilat ishin disfavorizuese për pjesëmarrjen në prokurimin publik por nuk ka publikuar Shtojcën ku duhet të pasqyrojë njëherazi edhe ndryshimet e dokumentave të procedurës së prokurimit për aq sa është pranuar prej autoritetit kontraktor duke publikuar shtojcën përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me përcaktimet e ligjit për prokurimin publik.

Megjithatë kërkojmë që Komisioni i Prokurimit Publik mos të anashkalojë faktin se autoriteti kontraktor duhet të pasqyrojë njëherazi ndryshimet e dhëna për dokumentat e procedurës së prokurimit për aq sa është pranuar prej tij duke publikuar shtojcën përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me përcaktimet e ligjit për prokurimin publik me qëllim njohjen e të gjithë operatorëve ekonomikë ankimues me sqarimet dhe modifikimet për dokumentat e tenderit për të qenë të qarta e të sakta për të gjithë të interesuarit për këtë procedurë prokurimi gjë e cila nuk ka ndodhur brenda afateve që operatori ekonomik ka të drejtë të ankimojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

[...]

II.5. Me shkresën me nr. 2073/68 prot, datë 16.06.2020, protokolluar me tonën me nr. 525/2 prot, datë 19.06.2020, me objekt “Dërgohet informacion” është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo i relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Për specifikimin “Kolimator automatic i pajisur me llampë Led” kërkojmë të shtohet fjala ekuivalent Për specifikimin Rrotullimiti Gantry për afërsisht : 0° , / $+90^{\circ}$; $0^{\circ}/-150^{\circ}$ i motorizuar Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (teshmange pixel binning) theksojmë që sipas këtij specifikimi nuk sqarohen këndet e rrotullimit pozicioni reference me të cilin llogariten këndet e kërkuara.

AK duhet të sqarojë këtë specifikim duke i dhënë mundësinë gjithë operatorëve të kuptojnë çfarë konkretisht AK kërkon.

Përgjigja e AK është një përgjigje standart e cila nuk bazohet në atë që ne kemi kërkuar pasi FEDOS nuk ka kërkuar që specifikimi të ndryshohet por ka kërkuar që AK të specifikojë këndet e rrotullimit pozicionin referencë me të cilin do llogariten këndet e kërkuara.

Në specifikimet teknike AK duhet të jetë më e qartë në atë që kërkon që të sigurojë qartësimin e të gjithë operatorëve ekonomikë dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në prokurim.

Në lidhje me specifikimin Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (teshmange pixel binning) theksojmë se të modifikohet dhe të shtohet “ose ekuivalente”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10 Specifikimet teknike, është përcaktuar:

1.MAMOGRAFI DIXHITALE

Sistemi me rreze X të mamografisë së integruar, për ekzaminimet dixhitale FFDM (Full Field Digital Mammography) bazuar në teknologjinë e Flat Panel për ekzaminim dhe diagnostikim. Mburoja e rrezatimit në përputhje me mbrojtjen standarde EN60601-1-3. Të përfshihet kolona mbeshetese.

Sistemi duhet të garantojë cilësinë më të lartë të imazhit dhe riprodhueshmërinë dhe duhet të ofrojë risi teknologjike

Struktura mbrojtese ndaj rrezatimit të jete e perfshire

Gjenerator me rreze X me fuqi të pakten 5kE ne 35kV

Te kontrollohet me mikroprocesor një fazor, me frekuencë të lartë, me fuqi të lartë

Gama e tensionit: afërsisht 20-35 KV

Gama e mAs: 1 – 600 mA/s

Te kete mbrojtje te tubit te rrezeve X nga mbingarkesa termike me sensor aktiv temperature te kontrolluar nga njesia qendrore.

Përzgjedhja e parametrave radiologjikë të jete automatikisht bazuar në densitetin e gjirit

Kompensim automatic te tensionit

Doze minimale per pacientin

Kolimator automatik,

I pajisur me llambe Led

Tubi I rrezeve X

Shpejtesia e rrotullimitte anodes jo me pak se 3000 rpm

Anoda të jete prej Tungstenit ose me mire për të zvogëluar dozën me përqendrim afërsisht.

0,1-0,3 mm dhe filtrim me material Al

Kapaciteti i nxehtësisë jo më pak se 300 kHU

Rrotullimi Gantry për afërsisht: 0 ° / + 90 °; 0 ° / -150 ° i motorizuar,

Rrotullim i motorizuar izocentrik i krahut

Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 75 cm, me frena elektromagnetike

Sistemi I shtypjes

Manual dhe i motorizuar me kode të ndryshme kompresimi

Me pajisje zmadhimi: jo më pak se 1,5X

Kompresimi (madhësi dhe teknika të ndryshme)

Afishim dixhital i forces së kompresimit, trashësisë, këndit, etj

Kontroll me motor lart ose poshtë me pedal te kembet,

Celesa rregulluese në të dyanët e ngjeshjes. Pajisje për rregullim të mirë

Paneli i sheshtë

Madhësia aktive e detektorit jo më pak se 24x30 cm

Detektor me të paktën 60% DQE të matur nën dozën 10mR.

Madhësia e pikselit, maksimum 90 µm

Perftim optimal i imazhit për të gjithë ekranin me rezolucion të plotë të gjirit

Për imazhim optimal të përfshirë përdorimin e AEC

Distanca nga burimi tek imazhi 65-66 cm

Levizje vertikale min 45-125 cm

Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (teshmange pixel binning)

Ëorkstation

Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Duhet të përfshihet CD / DVD regjistruet.

I pajisur me Ups 1000VA.

Te jete pajisur me printer per printimin e filmave.

Sistem operativ Ëindoës 10 ose me mire ose sisteme operative ekuivalente.

III.1.2. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues për trajtimin e ankesës sqaron se:

Përsa i përket specifikimit teknik Kolimator automatik i pajisur me llampë Led, KSHA sqaron që me kalimin e viteve dhe përparimin e teknologjisë llampat LED janë superiore ndaj teknologjive të tjera të ndriçimit për arsye thelbësore si: jetëgjatësi më e madhe, ndriçim më i mirë me konsum më të ulët energjie, çlirim i nxehtësisë më i ulët etj. Gjithashtu sqarojmë se për këtë artikull ka kompani të ndryshme prodhuese të cilat përmbushin më së miri këtë specifikim, fakt ky i provuar dhe me procedura të tjera të ngjashme të suksesshme.

Kërkesa juaj nuk pranohet.

Përsa i përket specifikimit Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (teshmange pixel binning), sqarojmë se ky specifikim është përcaktuar nga specialistët e fushave përkatëse mjekësore dhe synohet garantimi i cilësisë së lartë në procedurat mjekësore ku përdoret. Gjithashtu theksojmë që specifikimet janë konsultuar me produkte të prodhuesve të ndryshëm dhe synojnë një teknologji të lartë. Për më tepër, ky specifikim është përdorur dhe në procedura të tjera të ngjashme të cilat kanë rezultuar të suksesshme.

Kërkesa juaj nuk pranohet.

III.1.3. Në nenin 23, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se :

"1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve

teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

III.1.4. Në nenin 27, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, parashikohet se "*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara*".

III.1.5. Në nenin 30 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: "[...] *Procedura e hapur është procedura e preferuar në prokurimet.*"

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. KPP thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma "b" dhe "c" e LPP-së), janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specififikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specififikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specififikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*", i ndryshuar.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 23 të LPP-së, KPP gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar tre metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me referimin e standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo

sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. Metoda e dytë e hartimit të specifikimeve teknike lidhet me referimin e kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale. Gjithashtu, edhe metoda e tretë, e cila është një ndërthurje e dy metodave të mësipërme, por çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Autoritet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.8. Sa më sipër, KPP gjykon se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë parametra teknikë kufizues e përjashtues, por duhet të përcaktojë parametra minimalë me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Konkretisht, në këtë rast, referuar edhe pretendimeve të ankimuesit, gjykojmë se përcaktime të tilla si vetëm i llampës LED apo i specifikimit që sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit, janë tregues që nuk ndikojnë në performancën e produktit pra e rëndësishme është që produkti të arrijë qëllimin kryesor pra funksionimin e tij, ndaj KPP gjykon se, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë kufizime të tilla në përcaktimin e specifikimeve teknike për sa kohë që performanca e produktit arrihet me secilën formë të dizenjimit (pra realizohet performancë pavarësisht dizenjimit, domethënë performanca nuk varet nga dizenjimi), në kushtet kur edhe nga ana e autoritetit kontraktor në kthimin e përgjigjes dhe në informacionin e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk jep informacion në lidhje me performancën e produktit, por i referohet thjesht teknologjisë së lartë.

Sa më sipër, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike në lidhje me sa më sipër, duke aplikuar edhe termin “*ekuivalent*” me anë të së cilës operatorët ekonomikë mund të dëshmojnë se disponojnë produktet me specifikimet teknike të kërkuara, në funksion të realizimit të synimit dhe kontratës objekt prokurimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron në lidhje me këto kritere dhe autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës duke përcaktuar termin ekuivalent në lidhje me llampën LED dhe specifikimin teknik “Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (teshmange pixel binning)”.

III.2. Në lidhje me pretendimin e ankimuesit se *Për specifikimin Rrotullimiti Gantry për afërsisht : 0^2 , / $+90^0$; $0^0/-150^0$ i motorizuar*

Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (teshmange pixel binning) theksojmë që sipas këtij specifikimi nuk sqarohen këndet e rrotullimit pozicioni reference me të cilin llogariten këndet e kërkuara.

AK duhet të sqarojë këtë specifikim duke i dhënë mundësinë gjithë operatorëve të kuptojnë çfarë konkretisht AK kërkon.

Përgjigja e AK është një përgjigje standart e cila nuk bazohet në atë që ne kemi kërkuar pasi FEDOS nuk ka kërkuar që specifikimi të ndryshohet por ka kërkuar që AK të specifikojë këndet e rrotullimit pozicionin referencë me të cilin do llogariten këndet e kërkuara. Në specifikimet teknike AK duhet të jetë më e qartë në atë që kërkon që të sigurojë qartësimin e të gjithë operatorëve ekonomikë dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në prokurim, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10 Specifikimet teknike është përcaktuar:

Rrotullimiti Gantry për afërsisht: $0^{\circ} / + 90^{\circ}$; $0^{\circ} / -150^{\circ}$ i motorizuar.

III.2.2. Autoriteti kontraktor në lidhje me këtë specifikim në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues ka sqaruar se Komisioni pasi bëri verifikimet e nevojshme, duke garantuar parimin e barazisë, konkurrencës dhe mosdiskriminimit të përcaktuar në ligjin e prokurimeve vlerësoi se ky specifikim është përcaktuar nga specialistët e fushave përkatëse mjekësore, dhe synohet garantimi i cilësisë së lartë në procedurat mjekësore ku përdoret. Gjithashtu sqarojmë që specifikimet janë konsultuar me produkte të prodhuesve të ndryshëm dhe synojnë një teknologji të lartë. Kërkesa juaj nuk pranohet”.

III.2.3. Sa më sipër analizuar, konstatohet se, ankimuesi nuk ka ngritur pretendim se përse është përcaktuar një kriter i tillë, por ka kërkuar sqarime pasi sipas këtij specifikimi nuk sqarohen këndet e rrotullimit pozicioni reference me të cilin llogariten këndet e kërkuara.

AK duhet të sqarojë këtë specifikim duke i dhënë mundësinë gjithë operatorëve të kuptojnë çfarë konkretisht AK kërkon.

Përgjigja e AK është një përgjigje standart e cila nuk bazohet në atë që ne kemi kërkuar pasi FEDOS nuk ka kërkuar që specifikimi të ndryshohet por ka kërkuar që AK të specifikojë këndet e rrotullimit pozicionin referencë me të cilin do llogariten këndet e kërkuara.

Në specifikimet teknike AK duhet të jetë më e qartë në atë që kërkon që të sigurojë qartësimin e të gjithë operatorëve ekonomikë dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në prokurim.

III.2.4. Në nenin 42 të LPP-së, parashikohet se: “ [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

III.2.5. Sqarojmë se, sa më sipër, autoriteti kontraktor, duhet të bëjë sqarimet përkatëse, me faktin që operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, të jetë i qartë në lidhje me specifikimet teknike që duhet të përmbushë produkti që kërkohet.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është ky i fundit organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kriteret të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriteret apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe autoriteti kontraktor duhet të bëjë sqarimet përkatëse.

III.3. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: *Kërkojmë që specifikimi:*

- Certifikata/ose dëshmi trajnimi të tyre për pajisjet me poshtë **PER LOT 3:**

Pajisje radiologjike

Të modifikohet e të bëhet: Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjës të trajnuar për pajisjet mjekësore të vërtetuar me certifikata e trajnime, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, pika 11, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin: *Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij jo më pak se 2 (dy) inxhinierë biomedikalë ose elektronik ose informatik të trajnuar për servis pajisjesh mjekësore.*

Për këtë duhet të paraqesë:

Certifikatat/ose dëshmi trajnimi të tyre për pajisjet më poshtë: Për Lot 3:

Pajisje radiologjike

III.3.2. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues sqaron në lidhje me këtë pretendim se:

Pajisjet e përzgjedhura për të cilat janë kërkuar certifikata/dëshmi trajnimi të tyre janë pajisje mjekësore shumë të rëndësishme sidomos për institucionet spitalore përfituese. Institucionet spitalore përfituese kanë shprehur interesin si dhe kërkesën që operatorët ekonomikë të kenë staf të kualifikuar me qëllim instalimin e tyre, si dhe ofrimin e trajnimeve për stafin, me qëllim sigurimin në mënyrë profesionale servisin, mirëmbajtjen dhe mirëfunksionimin e tyre nga firmat ofertuese. Sqarojmë se është e drejtë e autoriteteve kontraktore të vendosin se për cilat prej pajisjeve mjekësore ka nevojë për trajnime.

Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

III.3.3. Operatori ekonomik ankimues pretendon se:

në dokumentat e tenderit në 2. Kriteret e vecanta të kualifikimit pika 2.3. Kapaciteti teknik pika 11, kërkohet:

- 2. Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij jo më pak se 2 (dy) inxhinierë biomedikale ose elektronik ose informatik të trajnuar për servis pajisjesh mjekësore.*

Për këtë duhet të paraqesë:

- Diplomat perkatese
- Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për periudhën Janar 2020 - Prill 2020 ku të figurojnë emrat e tyre
- Certifikata/ose deshmi trajnimi te tyre per pajisjet me poshte **PER LOT 3:**

Pajisje radiologjike

Lidhur me këtë specifikim teknik të kërkuar nga ana juaj theksojmë se:

Kërkesa juaj për trajnime specifike në aparaturat e sipërcituara është një kriter që nuk stimulon pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse të operatorëve ekonomikë. Autoriteti kontraktor duke përcaktuar specifikime teknike të cilat i ofron vetëm një operator ekonomik e bën konkurimin jo të drejtë duke mos patur një konkurim të paanshëm ku të gjithë ofertuesit të ofertojnë produktet e tyre.

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006[...] neni 23 pika 3 gërma b) përcakton se: [...]

Specifikimi teknik i vendosur nga ana juaj është vetëm një e dhënë me qëllim eliminimin e konkurrencës në këtë procedurë prokurimi.

Në këtë rast kemi specifikime të cilat vetëm kufizojnë ofertat për këtë produkt pasi nuk justifikohet vendosja e specifikimeve teknike për trajnime për aparatura specifike.

Operatorët ekonomikë pa dyshim që në stafin e tyre duhet të kenë punonjës të trajnuar për instalimin përdorimin e pajisjeve mjekësore, por absolutisht nuk mund të detyrohet një operator ekonomik të ketë një staf të trajnuar vetëm për aparaturat që kërkohen nëpërmjet këtij prokurimi.

Operatorët ekonomikë mund të kenë në staf punonjës të trajnuar dhe që dinë mirë instalimin dhe përdorimin dhe trajnimin e stafit për pajisjet mjekësore me procese më të vështira në instalim dhe përdorim se pajisjet që prokurohen, ndaj vendosja e këtij kriteri ku ata duhet të jenë të trajnuar vetëm për pajisjet e ofertuara është në kundërshtim me LPP dhe aktet nënligjor në fuqi.

VKM nr. 914/2014 në nenin 30 përcakton që [...].

Në rastin konkret ky parim absolutisht nuk respektohet sepse, një operator ekonomik mund të ketë pjesë të stafit teknik inxhinierët biomedikal, të trajnuar për instalimin e pajisjeve mjekësore të punësuar me kohë të plotë ose me kontrata pune të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës por edhe kohëzgjatjes së kontratës duke plotësuar kështu më së miri kriterin e stafit teknik punëmarrës të trajnuar për aparatura mjekësore.

Kërkojmë që specifikimi:

- Certifikata/ose deshmi trajnimi te tyre per pajisjet me poshte **PER LOT 3:**

Pajisje radiologjike

Të modifikohet e të bëhet: Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjës të trajnuar për pajisjet mjekësore të vërtetuar me certifikata e trajnime.

III.3.4. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se përcaktimi i bërë nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me legjislacionin në fuqi si më sipër cituar, pasi nga ana e tij është përcaktuar dokumenti që dëshmon trajnimin e stafit i cili do të merret me pajisjet radiologjike të cilat janë specifike nga përdorimi dhe rëndësia e tyre.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është ky i fundit organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kriteret të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriteret apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Sa më sipër referuar rëndësisë dhe specifikës që kanë këto pajisje mjekësore si edhe faktit që sqaron autoriteti kontraktor se *institucionet spitalore përfituese kanë shprehur interesin si dhe kërkesën që operatorët ekonomikë të kenë staf të kualifikuar me qëllim instalimin e tyre, si dhe ofrimin e trajnimeve për stafin, me qëllim sigurimin në mënyrë profesionale servisin, mirëmbajtjen dhe mirëfunksionimin e tyre nga firmat ofertuese; është e drejtë e autoriteteve kontraktore të vendosin se për cilat prej pajisjeve mjekësore ka nevojë për trajnime*, KPP gjykon se kriteri i vendosur është në proporcion me natyrën dhe objektin e kontratës.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në të drejtë të autoritetit kontraktor të vendosë ato kërkesa të veçanta kualifikimi të cilat nuk bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenit 27, pika 6 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Rrjedhimisht Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteri i mësipërm, në tërësinë e tij, në lidhje me specifikën e procedurës së prokurimit është në përputhje me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit parashikuar nga neni 2 gërma “a”, në drejtim të mos diskriminimit.

Rrjedhimisht sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar shtojcën, sqarojmë se nga verifikimet e bëra në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti ka publikuar shtojcën përkatëse ku janë pasqyruar edhe ndryshimet për disa nga pretendimet e ngritura nga ankimuesi.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-58406-05-18-2020, Loti 3, me objekt “*F.V. Pajisje radiologjike*”, me fond limit 25.666.667 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.06.2020, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik si më sipër cituar.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 525 Protokolli,

Datë 05.06.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri